

Historiku i shkollës fillore “Dy Dëshmorët” Dobrajë e Madhe

Shkolla fillore “Dy Dëshmorët” në Dobrajë e Madhe ka një histori të begatshme që nga themelimi e deri në ditët e sotme. Të dhënat për kohën më të re janë në arkivin e shkollës ndërsa për ato të më përparme është gjurmuar në arkivin e komunës.

Në vitin 1922 hapet shkolla e parë në shtëpinë e Rifat Llugiqit me gjashtëdhjet nxënës shqiptar dhe serb. Pasi që kolonistat e parë serb erdhën me 1921. Objekti ku zhvillohej mësimi atëherë kishte dy dhoma mësimi dhe një dhomë për mësuesin. Mësuesi i parë është quajtur Murganiq. Më vonë ka punuar mësues me gruan e tij Vela. Me 1929 është ndërtuar shkolla për herë të parë. Në fillim interesimi i qytetarëve ishte i pakët, por me kalimin e kohës ai vinte duke u shtuar sepse mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe.

Shkolla misionin e saj original e fillon gjatë luftës së dytë botërore, kur fillon mësimi edhe në gjuhën shqipe në shtator të viti 1941 nga mësuesi Brahim Stafa i cili erdhi nga Elbasani bashkë me Hasan Telin, i cili ishte mësues më parë në Rufe të Ri kur shkolla e Dobrajës filloi punën. Këta të dy kishin dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për mësimin e të shkruarit të gjuhës shqipe. Pastaj Halim Subashi, Anton e Leska Toni nga Shkupi, Franja e Lola – bashkëshort, Hamdie Cara nga Prishtina, Burbuqja – Shqipëri, e tjerë (që nuk i dijmë) deri në vitin 1944.

Më 1944 mësuesi i parë në prag të çlirimit ka qënë Mustafë Bahtiri.

Pas luftës së dytë botërore fillon një etapë e re në zhvillimin e arsimit dhe edukimit në gjuhën shqipe. Në vitin 1945/46 formohen klasë me mësuesit Sabri Ibrahimimi dhe Mustafë Bahtiri të cilët insistonin tek njerëzit që të dërgonin sa më shumë fëmijë në shkollë, për të ulur shkallën e analfabetizmit që në atë kohë ishte shumë i lartë. Pastaj Adem Blakqori – Podujevë, Aziz Kulinxha – Prishtinë, Sabit Qulli – Gadime, Avdi Demiri – Sazli, Gani Ajeti – Medvec, Daut Demaku – Obri. Në vitin 1950 formohen paralelet deri në klasën e pestë, e që në atë kohë klasa e pestë quhej klasë e parë e gjimnazit të ulët. Pas mbarimit të klases së pestë, nxënësit mësimet i vazhdonin në shkollën e Magurës. Në atë kohë kanë punuar Selatin Bytyqi – Shajkovc, Mehmet Shala – Kleçkë, Shaban e Hasime Shala – Sedllar (Shalë), Qazim Bytyqi – Dobrajë, Isuf Kavkazi – Ribar i Vogël, Faik Llugiqi e Ramush Ajvazi – Dobrajë e Madhe, Abaz Mehmeti, Ajet Fejza e

Ahmet Prekopuca – Gumnasellë, Rizah Shala – Risinovc, Fehmi Osmani – Rubovc, Mustafa Kolshi – Baicë, pastaj Sadik Bllaca, Jakup Lekiqi, Salih Mziu, Ejup Uka, Halim e Haki Llugiqi, Muharrem Brestovci, Ajet Kajtazi. Ndërsa në vitin 1967 Mehdi Berbatovci, Musa Bahtiri, Adil Rashiti, Adem Berisha. Në vitin 1970 Isa Bahtiri e Ragip Bahtiri, me 1971 Idriz Zhegrova, Dinore Brestovci, Bislim Dulahu, Musli Publica, Adem Publica. Me 1975 Rrustem Publica, Shefki Nuredini e tjerë me radhë deri tani.

Që nga viti 1958 e deri më 1988 shkolla ka funksionuar si paralele e ndarë fizike e shkollës së Magurës.

Me 11.10.1988 me vendimin e atëhershëm të Kuvendit Komunal, shkolla pavarësohet plotësisht dhe fillon me organe dhe udhëheqje të veten.

Aktualisht procesi mësimor zhvillohet në shkollën amë prej klasës së I-rë e deri në të IX-ën, ndërsa në paralelet e ndara në Dobrajë të Vogël, në Llugë dhe Gllanicë mësimi zhvillohet me paralele të kombinuara, klasa e parë me të tretën dhe e katërta me të dytën, për shkak të numrit të kufizuar të nxënësve.

Mësimi në shkollën amë këtu në Dobrajë të Madhe zhvillohet me dy ndërrime, ndërsa në paralelet e ndara mësimi zhvillohet me një ndërrim. Shkolla me krenari ka mbajtur emrin e shkrimtarit dhe revolucionarit tonë kombëtar Hivzi Sylejmani që nga 20.06.1992 nr. 8, me vendimin e Ministrisë së Arsimit të Republikës së Kosovës.

Ndërsa nga 30.10.2013 është bërë riemërimi i shkolles me vendimin e MASHT-it që mban emrin e dy dëshmorëve të fshatit Dobrajë e Madhe. Emri i Xhevdet Breznicës i cili u vra në Magurë me datën 01.02.1990 nga milicia Jugosllave - atëherë këto demonstrata për liri e demokraci; dhe Lulzim Llugiqit, i cili është vrarë duke luftuar me armë në dorë me datën 05.06.1999 në malet e Pashtrikut me emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ndërsa me datën 27.11.2013 shkollës iu vu pllaka me emrin e këtyre dy dëshmorëve.